



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

RREGULLORE

PËR
MJAFTUESHMËRINË E KAPITALIT TË SUBJEKTEVE QË USHTROJNË
VEPRIMTARINË NË TREGJET FINANCIARE TË BAZUARA NË TEKNOLOGJINË E
REGJISTRAVE TË SHPËRNDARË

Miratuar me Vendimin e Bordit nr. 210, datë 25.11.2021

Neni 1

Objekti i rregullores

Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i rregullave të detajuara në lidhje me përlllogaritjen e mjaftueshmërisë së kapitalit të subjekteve që ushtrojnë veprimtarinë si agjent TD, bursë DLT dhe kujdestar i portofolit të palëve të treta.

Neni 2

Baza ligjore

Kjo rregullore hartohet në përputhje me nenin 9, pika 3 dhe nenin 31, pika 1, germa gj, të Ligjit nr. 66/2020 “Për tregjet financiare të bazuara në teknologjinë e regjistrave të shpërndarë”.

Neni 3

Përkufizimet

Të gjitha përkufizimet e kësaj rregulloreje janë të njëjta me ato Ligjit nr. 66/2020 “Për tregjet financiare të bazuara në teknologjinë e regjistrave të shpërndarë”, të referuar në këtë rregullore si “Ligji”.

Neni 4

Mjaftueshmëria e kapitalit

1. Subjektet e përcaktuara në nenin 1 të kësaj rregulloreje, duhet të sigurojnë një nivel të mjaftueshëm të kapitalit, i cili duhet të jetë në çdo kohë jo më i ulët se vlera më e lartë e cilësdo prej shumave të mëposhtme:
 - a. Niveli minimal i kapitalit i përcaktuar në ligj për agjentin TD, bursat DLT dhe kujdestarët e portofolit të palëve të treta; ose
 - b. Një e katërta e shpenzimeve të përgjithshme fikse të vitit paraardhës, të rishikuara çdo vit, të përlogaritura sipas përcaktimeve të nenit 5, të kësaj rregulloreje.
2. Kriteri i përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, përmbushet nga subjektet përmes fondeve të veta, sipas përcaktimeve të nenit 6, të kësaj rregulloreje.
3. Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, mund të kërkojë rritjen e nivelit të mjaftueshëm të kapitalit të subjekteve, objekt i kësaj rregulloreje, në rastet kur:
 - a. Subjekti i mbikëqyrur ka pësuar ndryshime në veprimtarinë e tij tregtare, të cilat Autoriteti i konsideron si ndryshime me efekt material;
 - b. Autoriteti, gjatë mbikëqyrjes konstaton se:
 - i. Titullari i licencës është i ekspozuar ndaj risqeve ose elementeve të risqeve shtesë, të cilat nuk janë të mbuluara nga kërkesat aktuale për mjaftueshmërinë e kapitalit;
 - ii. Titullari i licencës nuk zbaton rregullat e brendshme në lidhje me menaxhimin e riskut dhe likuiditetit dhe masat administrative në diskrecion të Autoritetit nuk mund të përmirësojnë rregullat, proceset, mekanizmat, dhe polikat e brendshme brenda një kohe të përshtashme;
 - iii. Pas vlerësimit të portofolit të aseteve të mbajtura për tregtim, subjekti i licencuar është në pamundësi të shitjes ose mbrojtjes së pozicionit të tij, pa pësuar humbje materiale, nën kushte normale të tregtimit;
 - iv. Në rast të luhatjeve ciklike ekonomike rrezikohet veprimtaria operationale e titullarit të licencës, si dhe kur gjykohet se kërkesat për mjaftueshmëri kapitali nuk arrijnë të mbulojnë humbjet dhe risqet potenciale.

Neni 5

Shpenzimet fikse

1. Shpenzime fikse, janë shpenzimet që rrjedhin gjatë ushtrimit të veprimtarisë së zakonshme, pavarësisht rezultatit financiar të subjekteve të përcaktuara në nenin 1 të kësaj rregulloreje.
2. Shpenzimet fikse, llogariten si diferencë mes shpenzimeve totale të rezultuara nga pasqyrat financiare të audituara, duke zbritur shpenzimet e ndryshueshme.

3. Shpenzimet e ndryshueshme përbëhen nga:
 - a. Bonuse të stafit dhe shpërblime të tjera, në varësi të fitimit ushtrimor;
 - b. Shpërblime të tjera të ndryshueshme, në masën që ato nuk janë të detyrueshme;
 - c. Komisione dhe tarifa të pagueshme të përbashkëta, të cilat kanë lidhje të drejtpërdrejtë me komisionet dhe tarifatat e arkëtueshme, të përfshira në të ardhurat totale, ku pagesa e komisionit ose tarifës së pagueshme është e kushtëzuar nga marrja e komisionit ose tarifës së arkëtueshme;
 - d. Tarifatat e paguara për shtëpinë e klerimit dhe bursën për qëllime të ekzekutimit, regjistrimit ose të klerimit të transaksioneve;
 - e. Interesin e paguar kundrejt parave të klientëve;
 - f. Shpenzime të tjera të ndryshueshme.
4. Shpenzimet e jashtëzakonshme, të cilat janë shpenzime që shkaktohen nga ngjarje të jashtëzakonshme, që ndodhin rrallë, kanë materialitet, nuk janë pjesë e veprimtarisë së subjektit dhe nuk priten të ripërsëriten në të ardhmen, nuk konsiderohen si shpenzime fikse sipas pikës 1 të këtij neni.
5. Subjektet e përcaktuara në nenin 1 të kësaj rregulloreje, të cilët kanë më pak se një vit që ushtrojnë veprimtarinë e tyre, do të përdorin, për efekt llogaritjeje një të katërtën e shpenzimeve të përgjithshme fikse të përfshira në parashikimet e tyre për 12 muajt e parë të ofrimit të shërbimit, siç paraqitet në kërkesën e tyre për licencim.

Neni 6

Fondet e veta

1. Fondet e veta të subjekteve të përcaktuara në nenin 1 të kësaj rregulloreje përbëhen nga:
 - a. Kapitali i nënshkruar dhe i shlyer;
 - b. Rezervat e kapitalit, të cilat krijohen nga shpërndarja e fitimit me vendim të organeve vendimmarrëse, në zbatim të kuadrit ligjor dhe rregullator në fuqi;
 - c. Rezerva e rivlerësimit, ku përfshihen rezervat që krijohen nga rivlerësimi me rritje të vlerës kontabël të elementeve të aktiveve materiale afatgjatë (ulja në vlerë pasqyrohet në pasqyrën fitim/humbje). Këtu përfshihen dhe ndryshimet – rritje/ulje në vlerë (përveç humbjes së vlerës dhe efekteve të normave të këmbimit) – të investimeve financiare të kategorizuara si të vlefshme për shitje;
 - d. Rezerva të tjera, të ndryshme nga ato më lart;
 - e. Fitimet e pashpërndara dhe humbjet e mbartura nga periudhat e mëparshme;
 - f. Fitimi ushtrimor i periudhës raportuese.

duke zbritur:

- g. Humbje të periudhës raportuese;
- h. Investime në aktive të patrupëzuara;

- i. Aksionet e veta të riblera;
- j. Pjesëmarrje dhe instrumente të borxhit të varur (obligacione të nënrenditura) në një tjetër subjekt që ushtron veprimtarinë në tregjet financiare të bazuara në teknologjinë e regjistruar të shpërndarë, grup kontrollues të këtyre subjekteve, shoqëri komisionere, banka dhe/ose degë të bankave të huaja, shoqëri sigurimi/risigurimi, shoqëri administruese dhe institucione të tjera financiare, në të cilat shoqëritë, objekt i kësaj rregulloreje, zotërojnë pjesëmarrje influencuese mbi 10 përqind;
- k. Investime të tjera në personat e parashikuar në shkronjën “j”, të këtij neni, që janë përfshirë në llogaritjen e kapitalit të subjekteve përkatëse;
- l. Pjesëmarrjet dhe titujt e borxhit të varur (obligacione të nënrenditura), si dhe investime të tjera në një subjekt që ushtron veprimtarinë në tregjet financiare të bazuara në teknologjinë e regjistruar të shpërndarë, ose institucione financiare, të përmendura në shkronjën “j”, të kësaj pike, të cilat kalojnë masën 10% (dhjetë) të kapitalit të subjektit në fjalë;
- m. Aktive, të cilat nuk janë të lira nga çdo përgjegjësi apo detyrim i parashikuar;
- n. Aktive jolikuide, të cilat përfshijnë:
 - i. Aksionet e palistuara në tregje të rregulluara;
 - ii. Huatë/llogaritë e arkëtueshme me palë të lidhura;
 - iii. Debitorë të tjerë ose llogari të tjera të arkëtueshme, të cilat nuk rrjedhin drejtpërsëdrejti nga veprimtaria e subjektit;
 - iv. Inventari;
 - v. Shpenzimet e parapaguara;
 - vi. Aktivitet e tjera, të cilat nuk janë të lira nga çdo përgjegjësi apo detyrim i parashikuar;
 - vii. Aktivitet e tjera, të cilat nuk janë lehtësisht të kthyeshme në para në momentin kur është e nevojshme përmbushja e detyrimeve financiare kur u vjen afati.

Neni 7

Kërkesat për likuiditet

1. Fondet e veta të subjekteve të përcaktuara në nenin 1 të kësaj rregulloreje duhet të mbahen në formë likuide. Aktive likuide për efekt të pikës 1 të këtij neni do të konsiderohen:
 - a. Mjete monetare dhe depozita bankare me afat deri në 1 vit;
 - b. Tituj Borxhi të shteteve të vendeve anëtare të Bashkimit Evropian dhe/ose vendeve anëtare të OECD-së, me vlerësim të kreditit të paktën BBB-;
 - c. Tituj borxhi të emetuara dhe/ose të garantuara nga Banka Qendrore Evropiane, Banka Evropiane e Investimeve dhe Banka Botërore;
 - d. Bono thesari të emetuara nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë në monedhën lokale.
2. Mjetet monetare dhe depozitat bankare, të përcaktuara në pikën 1, germa a, të këtij neni nuk duhet të tejkalojnë 33% (tridhjetë e tre) e vlerës së kapitalit (që përfshin të gjitha gerrat e pikës 1 të këtij neni) në një bankë të vetme.

Neni 8

Detyrimet për raportim

1. Agjenti TD, bursa DLT dhe kujdestari i portofolit të palëve të treta duhet të raportojnë në Autoritet për plotësimin e kërkesës për mjaftueshmëri kapitali në baza vjetore, brenda muajit të parë të vitit pasardhës. Forma, përmbajtja dhe mënyra e plotësimit të raportit mbi mjaftueshmërinë e kapitalit përcaktohen në shtojcën 1 të kësaj rregulloreje.
2. Në funksion të përmbushjes së detyrimeve të përcaktuara në kreun III të ligjit, agjenti TD kontrollon në mënyrë të vazhdueshme mjaftueshmërinë e kapitalit të titullarëve të licencës, për të cilët vepron në emër dhe për llogari, si dhe njofton Autoritetin në lidhje me përputhshmërinë e nivelit të kapitalit me kërkesat e kësaj rregulloreje, të paktën mbi baza tremujore.
3. Pavarësisht përcaktimeve të këtij neni, subjektet e përmendura në pikën 1, njoftojnë menjëherë Autoritetin, vetë ose përmes agjentit TD, në rast se fondet e veta të shoqërisë bien nën nivelin e kërkuar sipas kësaj rregulloreje.

Neni 9

Shkeljet

Mosrespektimi i dispozitave të kësaj rregulloreje përbën shkelje dhe ndaj subjektit shkelës ndërmerren masat administrative të parashikuara në nenin 19 dhe Kreun XI të ligjit.

Neni 10

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë.

Shtojca 1. Formular raportimi mbi mjaftueshmerinë e kapitalit

Subjekti _____

Periudha
raportuese _____

Fondet e veta		
Nr.	Përshkrimi	Vlera
I	Kapitali (a+b+c+d+e+f)	0
a	Kapitali aksionar i nënshkruar dhe i shlyer	
b	Rezerva e kapitalit	
c	Rezerva e rivlerësimit	
d	Rezerva të tjera	
e	Fitimet e pashpërndara dhe humbjet e mbartura nga periudhat e mëparshme	
f	Fitimi ushtrimor i periudhës raportuese	
II	Elementet që zbriten (g+h+i+j+k+l+m+n)	0
g	Humbjet e periudhës raportuese	
h	Investime në aktive të patrupëzuara	
i	Aksionet e veta të riblera	
j	Pjesëmarrje dhe instrumente të borxhit të varur (obligacione të nënrenditura) në një tjetër subjekt që ushtron veprimtarinë në tregjet financiare të bazuara në teknologjinë e regjistruara të shpërndarë, grup kontrollues të këtyre subjekteve, shoqëri komisionere, banka dhe/ose degë të bankave të huaja, shoqëri sigurimi/risigurimi, shoqëri administruese dhe institucione të tjera financiare, në të cilat shoqëritë, objekt i kësaj rregulloreje, zotërojnë pjesëmarrje influencuese mbi 10 përqind	
k	Investime të tjera në personat e parashikuar në shkronjën “j”, që janë përfshirë në llogaritjen e kapitalit të subjekteve përkatëse	
l	Pjesëmarrjet dhe titujt e borxhit të varur (obligacione të nënrenditura), si dhe investime të tjera në një subjekt që ushtron veprimtarinë në tregjet financiare të bazuara në teknologjinë e regjistruara të shpërndarë, ose institucione financiare, të përmendura në shkronjën “j”, të kësaj pike, të cilat kalojnë masën 10 përqind të kapitalit të subjektit në fjalë	
m	Aktive, të cilat nuk janë të lira nga çdo përgjegjësi apo detyrim i parashikuar	
n	Aktive jo likuide (n.i deri në n.vii)	0
n (i)	Aksionet e palistruara në tregje të rregulluara;	
n (ii)	Huatë/llogaritë e arkëtueshme me palë të lidhura;	
n (iii)	Debitorë të tjerë ose llogari të tjera të arkëtueshme, të cilat nuk rrjedhin drejtpërsëdrejti nga veprimtaria e subjektit;	
n (iv)	Inventari;	
n (v)	Shpenzimet e parapaguara;	
n (vi)	Aktivet e tjera, të cilat nuk janë të lira nga çdo përgjegjësi apo detyrim i parashikuar;	
n (vii)	Aktivet e tjera, të cilat nuk janë lehtësisht të kthyeshme në para në momentin kur është e nevojshme përmbushja e detyrimeve financiare kur u vjen afati	
III	Fondet e veta (I-II)	0

Shpenzime fikse		
Nr.	Përshkrimi	Vlera
I	Totali i shpenzimeve	
II	Shpenzimet e ndryshueshme (1.1 deri 1.6)	0
1.1	Bonuse të stafit dhe shpërblime të tjera, në varësi të fitimit ushtrimor	
1.2	Shpërblime të tjera të ndryshueshme, që ato nuk janë të detyrueshme	
1.3	Komisione dhe tarifa te pagueshme, të cilat kanë lidhje të drejtpërdrejtë me komisionet dhe tarifatat e arkëtueshme	
1.4	Tarifatat e paguara për shtëpinë e klerimit dhe bursën për qëllime të ekzekutimit, regjistrimit ose të klerimit të transaksioneve	
1.5	Interesin e paguar kundrejt parave të klientëve	
1.6	Shpenzime të tjera të ndryshueshme	
	Totali i shpenzimeve fikse (I-II)	0